# AKT-THEMELTAR

Sot me date 21.10.1996,ne Tirane,zoti Mehmet Gezhilli,i biri i Tahirit,lindur me 1943,banues ne Tirane ne rrugen "Shyqyri Pesa",pallati shkalla 1,apartamenti 5,krijon shoqerine tregetare "ARGETA-LMG"SHPK.

Veprimtaria e shoqerisetregetare do te zhvillohet mbi bazen e akteve themeltare te krijimit si kontrata dhe statuti i shoqerise.Vperimtarine shoqeria tregatre"ARGETA-LMG" do ta filloje meregjistrimin ne Gjykaten e Rrethit Tirane si edhe ne zyrat e finances se Bashkise Tiran Shoqeria ne te gjithe veprimtarine e saj do te bazohet ne aktet ligjore e nenligjore te shtetit shqipetar.

Neni 1

Orataku i vetem Mehmet Gezhilli vendosi qe shoqerine tregetare te quhet "ARGETA-LMG".Selia e shoqerise do te jete ne rrugen "Shyqyri Pesa",pallati 4,shkalla 1,apartamenti 5,Tirane.

Neni 2

Objekti i shoqerise "ARGETA-LMG" do te jete:"Veprimtari ne fu botuese te librave,gazetave,revitave,kartolina,flete palosje,disketa e vidiokaseta e gjitheçka tjeter qe lidhet me botimin dhe tregetimin e t si brenda dhe jashte vendit".Shoqeria ka te drejte te ushtroje dhe vep mtari te tjera ekonomike e tregatre,qe lidhen me objektin e veprimtari ne menyre te drejtperdrejt ose te terthorte.

Neni 3

Kapitali themltar i shoqerise fillimisht do te jete 1380000 kjo e konfirmuar edhe nga banka.

Neni 4

Administrator i Pergjitheshem i shoqerise tregatre "ARGETA-LM do te jete zoti Mehmet Gezhilli.

Neni 5

Administratori i Pergjitheshem ka te gjitha kompetencat,te c lat ai deklarohet se i njeh dhe i pranon per ti kryer te gjitha dety qe i lindin ne baze te statutit te shoqerise "ARGETA-LMG",sikurse pa

Shikohet ne legjislacionin shqipetar dhe ne menyre te veçante ne "Kodin e shoqerive tregatre".

Neni 6

Ortaku i vetem Mehmet Gezhilli,pasi u njoh dhe i kupton drejt te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga akti ithemelimit te shoqe- rise tregetare "ARGETA-LMG",e gjen me vend dhe e firmos.

ADMINISTRATORI I PERGJITHESHEM

MEHMET GEZHILLI

# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ARGETA-LMG"

Zoti Mehmet Geshilli,si ortak i vetem,lindur me 1943,banues ne Tirane,rruga "Shyqyri Pesa",pallati 4,shkalla 1,apartamenti 5,me leter njoftimi UG Nr.278908,ka hartuar si me poshte statutin e nje shoqerie tregetare me pergjegjesi te kufizuar,i cili e themelon ne baze te aktit te themelimit, qe i bashkengjittet ketij statuti.

### FORMA,EMERTIMI,SELIA,KOHEZGJATJA

Neni 1

Ndermjet statutit si akt themelor,eshte krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me dispozitat e ktij statuti.

Neni 2

Emertimi i shoqerise eshte "ARGETA-LMG",me karakter juridik SHPK.

Neni 3

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte:"Veprimtari ne fushen botuese,botim librash,gazetash,revista,kartolina,fletepalosje,videokaseta,disketa me tekste dhe gjitheçka tjeter qe ka te bje me botimin dhe tregetimin e tyre me shumice dhe pakice si brenda dhe jashte vendit.Shoqeria ka te drejte te ushtroje edhe veprimtari te tjera ekonomike e tregetare qe lidhen drejtperdrejt ose me menyre te terthorte me objektin e veprimtarise".

Neni 4

Selia e shoqerise eshte ne Tirane,ne adresen rruga "Shyqyri Pesa" pallati 4,shkalla 1,apartamenti 5.Transferimi i selise ne nje vend tjeter behet me miratim te Administratorit te Pergjitheshem.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe mbi 10 vjet,duke filluar nga data e regjistrimit ne Gjykaten e Rrethit Tirane. Kjo periudhe mund te zgjatet toj afatit te mesiperm ose te shkurtohet,kur shoqeria prishet para kohe,per shkaqe te parashikuara ne ligj.

## KAPITALI I SHOQERISE

### Neni 6

Kapitali fillestar i shoqerise tregetar "ARGETA-LMG" SHPK eshte 1380000 leke.

### Neni 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te marra nga pronari i shoqerise.

## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

### Neni 8

Shoqeria tregetare "ARGETA-LMG" deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe pemmban ky statut,ato te legjislacionit shqipetar. Ajo eshte krijuar e do te veproje me regjimin e prones private dhe merr persiper te drejta e detyrime.

Shoqeria pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore dhe ja
shte kontraktore,brenda kapitalit te saj dhe prones se fituar.

### Neni 9

Shoqeria tregetare "ARGETA-LMG" eshte krijuar dhe mbetet prone private e zotit Mehmet Gezhilli.Vendimet e marra prej tij ne zbatim te
gjeve ne fuqi dhe sipas ketij statuti,jane te detyrueshme per te gjithe te punesuarit ne kete shoqeri.

### Neni 10

Pronari i shoqerise Mehmet Gezhilli eshte edhe Administrator Pergjitheshem i saj.Sipas nevojave qe do te paraqiten per zhvillimin e shoqerise,emron administratoret dhe punonjesit e saj,keshillin Adminis
tiv si dhe puneson puntore te veprimtarive te ndryshme.

### Neni 11

Administratori i Pergjitheshem i shoqerise dhe me autorizim
tij,administratoret e emruar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqi
per drejtimin e zakoneshem dhe te jashtezakoneshem te shoqerise,kane
ndesite te kryejne te gjitha aktet qe konsiderohen te nevojeshme per
itjen e qellimeve te shoqerise.

Ne çdo rast Keshilli Administrativ dhe administratoret e sh

rise kane per detyre te japin llogari dhe te njoftojne Administratorin e Pergjitheshem.

Neni 12

Administratori i Pergjitheshem emron administratoret dhe punonjesit e shoqerise si dhe punetore e specialiste te nevojeshem per kryerjen e veprimtatise se saj,duke respektuar legjislacionin ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore.Ne aktin e emrimit te tyre ai u cakton pagen dhe detyrat qe kane,ndersa te gjithe punonjesit e shoqerise jane te detyruar te pranojne statutin dhe gjithe detyrat qe do tu ngarkohen.

Neni 13

Administratoret nuk marrin cilesine e ortakut te shoqerise dhe as nuk mund te ushtrojne nje veprimtari konkuruese te çfardolloji per llogari te tyre ose te treteve,perveç atyre te autorizuara nga Administratori i Pergjitheshem.Per çdo shkelje ne kete drejtim,administratori ose punonjesi tjeter largohet nga shoqeria dhe pergjigjet per demin e shkaketuar.

Neni 14

Shpenzimet e nevojeshme per mbajtjen e administratoreve dhe te punonjesve te tjere perballohen nga shoqeria.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 15

Perfaqesimi i shoqerise "ARGETA-LMG" i perket Administratorit te Pergjitheshem,zotit Mehmet Geshilli si dhe administratoreve te caktuar prej tij,keta zbatojne te gjitha vendimet e marra prej tij e te Keshillit Administrativ,ne kuadrin e te drejtave te dhena atyre ne aktin e emrimit ose me procesverbal te veçante.

Administratori i Pergjitheshem dhe administratoret e tjere kane te drejte te perfaqesojne shoqerine ne organet gjyqesore e gjykime,te oktojne e te punesojne avokat per çeshtjet ne gjykim.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 16

Veprimet ekonomike dhe financiare te shoqerise mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti,perveç kur kerkohet me urdher te Veçante te Admini-

stratori i Pergjithshem.Ne fund te periudhes tremajore Keshilli i Administratit ose administratoret nxjerrin bilancin kontabel me resultatin ekonomik humbje-fitim,basuar ne ligjet dhe regullate mbajtjes dhe administrimit te sektorit privat,te caktuara nga organet kompetente financiare.Bilanci kontabel miratohet nga Administratori i Pergjithshem.

Neni 17

E ardhura neto pas veçimit te fondit te akumulimit dhe pageses se detyruar fiskale,i mbetet per perdorim pronarit,eshte e drejta e tij te vendose per menyren e perdorimit te metejeshem te ketyre fondeve.

SHPERBERJA E SHOQERISE

Neni 18

Shperberja e shoqerise mund te vije ne çdo kohe dhe per çdo shkak.Pronari i shoqerise vendos mbi menyren e likuidimit dhe cakton nje ose disa likuidatore,duke ju percaktuar detyrat.

Neni 19

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete akt themelimi e statut te shoqerise ,i referohet çdo ligji te veçante perkates si dhe legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 20

Ky statut perpilohet ne disa kopje per tua shperndare organeve perkatese dhe nje kopje mbete si pjese e dokumentacionit te shoqerise "ARG TA-LMG" SHPK.

ADMINISTRATORI I PERGJITHESHEM

MEHMET GEZHILLI